REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| I | Data 29.01.24 | Vendi KAÇANIK |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 104/02-2776 | / |

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET

## 2024 – 2026

## KOMUNA E KAÇANIKUT

29 / 01 2024

## Përmbajtje

Deklarata e Kryetarit të Komunës ........ 2
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit ........ 6
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit ........ 7
Metoda e vlerësimit të rrezikut ........ 7
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut ........ 8
Monitorimi i Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Raportimi ........ 9
Fushat e rrezikut ........ 10
Fushat e përgjithshme të Rrezikut ........ 10
Fushat specifike të rrezikut ........ 10

**Deklarata e Kryetarit të Komunës**

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklarate gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që Komuna të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet ligjore, të përcaktuara në nenin 25 Ligjit Nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planeve të Integritetit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Zotohemi që Komuna e Kaçanikut me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me Plan të Integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet dhe objektivat në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën Kundër-Korrupsion në punën e organeve të Administratës Komunale. Përmes Planit të Integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i riskut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e riskut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individ, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojmë sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky Plan i Integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën Kundër Korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të ligjeve në fuqi, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Kaçanikut, dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit Nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planeve të Integritetit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Kaçanikut, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së integritetit brenda Komunës dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Kaçanikut për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të Komunës.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës.

**Plani i integritetit mundëson:**

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdolloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një komunë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e Korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale.

**Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:**

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative, duke vënë përpara një menaxhim pro aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve Operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të punonjësve komunalë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij plani, Komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, Komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të

dobëta të komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Kaçanikut e ka bërë në periudhën Shtator – Dhjetor 2023. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

**Qëllimet e Planit të Integritetit janë:**

- Sistemi efektiv i menaxhimit të integritetit në Komunë;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në Komunë.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson Integritetin e Punës, Integritetin Institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si Komuna dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës.

- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës. I gjithë stafi komunal ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

### Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza e parë :** Kryetari i Komunës ka themeluar Grupin Punues; me ç'rast ka përcaktuar strukturën e këtij grupi si dhe ka caktuar Koordinatorin-en/Kryesuesin-en e tij; Ka emëruar Personin përgjegjës për Mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit për Komunën e Kaçanikut. Grupi Punues pas emërimit ka bërë takimin e parë të punës me ç'rast ka informuar përfaqësuesit e secilës drejtori dhe zyre, ka njoftuar punonjësit në kuadër të komunës me rëndësinë e Planit të Integritetit me qëllim që të mund të bëjnë mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e Planit të Integritetit, ka zhvilluar takime me zyrtar të Komunës.
  Grupi punues ka shqyrtuar kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

- **Faza e dytë:** Grupi punues ka shfrytezuar pyetësorin gjithëpërfshirës, si dhe ka realizuar intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit me punonjës të Komunës. Mbi bazën e rezultatit të pyetësorit, përcaktohen fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.

- **Faza e tretë:** Koordinatori së bashku me Grupin Punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Komunës; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale ka përcaktuar fushat e rrezikut dhe ka bërë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve duke ka përdorë të dhënat e siguruara nga zyrtaret e secilës drejtori dhe zyre për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresojnë cenueshmërinë e integritetit dhe kanë propozuar masat për përmirësim. Në fund, Komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

### Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit te rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut




Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

### Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

| Ulët | Mesatar | Lartë |
|---|---|---|
| 1 – 15 pikë | 16 - 48 | 49 - 100 |

Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## Monitorimi i Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda Komunës dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara që janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e Planit të Integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda Komunë, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Drejtimi dhe Menaxhimi;
- Politika e Burimeve Njerëzore, Sjellja Etike dhe Profesionale e të Punësuarve;
- Planifikimi dhe Menaxhimi Financiar;
- Komunikimi dhe Informimi;
- Ruajtja dhe Siguria e të Dhënave dhe Dokumenteve.

### Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike të rrezikut janë:

- Auditimi i Brendshëm;
- Prokurimi Publik;
- Menaxhimi i Projekteve/Kontratave;
- Përfaqësimi / Mbrojtja e Interesit Legjitim të Komunës;
- Administrata Komunale;
- Menaxhimi i Pronës Komunale;
- Subvencionet, Grandet dhe Bursat;
- Planifikimi Urban dhe Rural;
- Standardet e Ndërtimit dhe Kontrolli;
- Inspektimet;
- Rekrutimi i Stafit dhe Mirëmbajtja në Arsimin Publik;
- Rekrutimi, Ofrimi i Shërbimeve të Shëndetit Publik – Ofrimi i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor;
- Realizimi i Projekteve dhe Politikave në Bujqësi;
- Ofrimi i Shërbimeve të QPS-së, dhe Zhvillimi i Politikave të Mirëqenies Sociale;
- Ofrimi i Shërbimeve në Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyejve;
- Zhvillimi i Politikave dhe Realizimi i Projekteve në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Realizimi i Politikave në Fushën e Sigurisë dhe Emergjencave;
- Menaxhimi i Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës;
- Realizimi i Projekteve në Fushën e Ekonomisë, Turizmit dhe Integrimeve. 

<table>
<tr><th colspan="10">Planit i Integritetit</th></tr>
<tr><th colspan="10">Fushat e përgjithshme të rrezikut</th></tr>
<tr><th colspan="3">Regjistrimi i Rrezikut</th><th colspan="3">Vlerësimi dhe Matja e Rrezikut</th><th colspan="4">Veprimi ndaj Rrezikut</th></tr>
<tr><th>Fusha e Rrezikut</th><th>Përshkrimi i Rrezikut</th><th>Masat ekzistuese të kontrollit</th><th>Gjasat</th><th>Ndikimi</th><th>Vlerësimi i rrezikut</th><th>Masat Propozuara Zvogëlimin Eliminimin Rreziqeve</th><th>Njësia/Zyrtari Përgjegjës</th><th>Afati i Realizimit</th><th>Niveli i Përmbushjes së Masave</th></tr>
<tr><td>Drejtimi dhe Menaxhimi</td><td>Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në PlaninZhvillimor Mosplotësimi i vendeve të punës në Zyrën e Kryetarit</td><td>Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës</td><td>4</td><td>5</td><td>20</td><td>Emërimi i Stafit në Zyrën e Kryetarit sipas legjislacionit në fuqi.</td><td>Zyra e Kryetarit, Kryetari i Komunës</td><td>Gjatë vitit 2024</td><td>/</td></tr>
</table>

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Politika e Burimeve Njerëzore, Sjellja Etike dhe Profesionale të Punësuarve** | | | | | | | | | |
| | Mosrealizimi i planeve vjetore të punës | | 3 | 5 | 15 | Koordinimi në realizimin e planeve vjetore të punës | Zyra e Kryetarit, Kryetari i Komunës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mos lajmërimi për pranimin e dhuratave | Ligjet në fuqi | 3 | 6 | 18 | Lajmërimi i zyrtarit kontaktues me Agjensionin Kundër Korrupcionit | Zyrtari kontaktues me Agjensionin Kundër Korrupcion, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerzore, drejtoret e Drejtorive, zyrtartet | TM4 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Politika e Burimeve Njerëzore, Sjellja Etike dhe Profesionale të Punësuarve** | Mosplotësimi i vendeve të punës | | 3 | 5 | 15 | Implementimi i Planit të Personelit | Zyra e Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mosrespektimi i Orarit të Punës | | 7 | 9 | 63 | Monitorimi i vijueshmërisë në punë | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme dhe drejtorit tjera | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mungesa e Trajnimeve Adekuate | | 7 | 7 | 49 | Planifikimi i Trajnimeve Adekuate të Vazhdueshme | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| **Planifikimi dhe Menaxhimi Financiar** | Pagesat direkte nga Thesari | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 7 | 5 | 35 | Buxhetimi shtesë për komunat për mbulimin e shpenzimeve të Kontratave kolektive për arsim dhe shëndetësi Ngritja e performancës së planifikimit të investimeve kapitale, për të parandaluar tejkalimin e vlerave të kontratave | Ministria e Arsimit, Shkrencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Drejtorët e drejtorive komunale, Menaxherët e Kontratave. | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mosplanifikimi në detaje i Planit të keshit | | 6 | 7 | 42 | Planifikimi i Planit të Keshit të jetë i detajuar dhe mirë i planifikuar, duke u bazuar në planifikime tre mujore të buxhetit | Drejtorët e drejtorive komunale së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. | Gjatë vitit 2024 dhe në vazhdimësi | / |
| | Vështirësitë gjatë regjistrimit të pronave në teren | | 4 | 4 | 16 | Krijimi i kushteve adekuate për zyrtarët që janë përgjegjës për regjistrim të pronave komunale në teren | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Sektori i Tatimit në Pronë | Gjatë vitit 2024 | |
| | Menaxhimi jo i duhur i rexhistrave të pasurisë – rexhistrimi dhe vlersimi i pasurisë komunale | | 3 | 5 | 15 | Të ndërmerren aktivitete, formohen komisione për vlerësimin e Pasurisë së Komunës, | Drejtoria e administratës së përgjithshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Gjatë periudhës 2024 | |
| | Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi | 5 | 5 | 25 | Marrja e veprimeve procedurale të parapara me ligjet në fuqi – zhvillimi i procedurës përmbarimore | Kryetari Drejtoria Për Buxhet dhe Financa, Përfaqsuesi Ligjor i Komunës | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Komunikimi dhe Informimi** | Mungesa e Pjesëmarrjes gjatë Hartimit të Buxhetit dhe | Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. | 6 | 8 | 48 | Komunikimi i strukturuar në gjithë procesin e konsultimit publik | Kabineti i Kryetarit, Njësia për Komunikim me Publikun, dhe Njësitë tjera komunale | Gjate periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rregulloreve Komunale | dhe aktet e brendshme të komunës | | | | | | | |
| | Mungesa e Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqeritë Civile | | 6 | 8 | 48 | Hartimi i Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqëritë Civile | Kryetari i Komunës | Gjate kësaj periudhës 2024-2026 | / |
| **Fushat e veçanta të rrezikut** | | | | | | | | | |
| **Regjistrimi i rrezikut** | | | **Vleësimi dhe matja e rrezikut** | | | | **Veprimi ndaj rrezikut** | | |
| **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masat ekzistues e të kontrollit** | **Gjasat** | **Ndikimi** | **Vlerësimi i rrezikut** | **Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati** | |
| Auditimi i Brendshëm | Mungesa e trajnimeve për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Komitetin e Auditimit | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshm | 5 | 7 | 35 | Planifikimi i Trajnimeve Adekuate të Vazhdueshme | Kryetari i Komunës, Njësia për Auditim të Brendshëm, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Periudha e parë e 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mos implementimi i rekomandimev të dhëna | e të komunës | 7 | 8 | 56 | Përpilimi i Planit për implementim nga menaxhmenti i Komunës dhe shqyrtimi i tij në baza mujore | Kryetari i Komunës, Drejtoritë e Komunës, dhe Njësitë në kuadër të Komunës | Disa deri në tre mujorin e fundit të vitit 2024 dhe disa tjera gjate viteve vijuese | / |
| Përfaqësimi / Mbrojtja e Interesit Legjitim të Komunës | Bashkëpunimi jo i plotë ndërinstitucional në ofrim të informatave / dokumentacion relevant | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 3 | 5 | 15 | Aplikimi i masave sanksionuese ndaj zyrtarëve përgjegjës dhe vetëdijësimi i drejtorive dhe zyrtarëve përgjegjës për rëndësinë e bashkëpunimit në ofrim të informacionit dhe dokumenteve relevante | Kabineti i Kryetarit | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mungesa e lëndëve dhe dokumentacionit të trashëguar nga paradhësi i përfaqësuesit ligjor | | 5 | 7 | 35 | Ofrimi i dokumentacionit nga Njësitë Përgjegjëse për lëndët që janë në proces gjyqësor me qëllim të mbrojtjes së interesit të komunës | Drejtoritë e Komunës / Zyrtarët Komunal | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Informacioni i mangët në lidhje me | | 3 | 6 | 18 | Bashkëpunim në lidhje me procesimin e lëndëve ndërmjet zyrtarëve të komunës | Zyrtarët e Komunës | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | procesimin e lëndëve | | | | | dhe Përfaqësuesit Ligjor të Komunës | | | |
| Prokurimi Publik / Menaxhimi i Kontratave | Mos planifikimi adekuat nga Njësitë e Kërkeses | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 5 | 7 | 35 | Planifikimi me kohë i Prokurimit nga Njësitë e Kërkesës | Zyra e Kryetarit, Zyra e Prokurimit dhe Drejtoritë Komunale | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mos plotësimi i Vendeve të Punës | | 8 | 8 | 64 | Plotësimi i vendeve të punës me staf Profesional | Zyra e Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Mungesa e Trajnimeve Adekuate | | 6 | 7 | 42 | Planifikimi i Trajnimeve Adekuate të Vazhdueshme | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| Administrata Komunale / Subvencionet dhe Bursat | Mungesa e Digjitalizimit të shërbimeve komunale | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, | 4 | 4 | 16 | Krijimi i platformës për ofrimin e shërbimeve online | Drejtoria për të Administratë Përgjithshme | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e përfshirjes në rregulloren për subvencionim të studentëve të në Universitetet e Rajonit | dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 5 | 30 | Përfshirja e studentëve dhe nxënësve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në draft – Rregullore për subvencionim | Kryetari i Komunës, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme | Periudha e parë e vitit 2024 | / |
| Menaxhimi i Pronës Komunale | Plotësimi i Pozitave Udhëheqese dhe Profesionale në Sektorin e Kadastrit | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 5 | 7 | 35 | Zhvillimi i procedurave të Rekrutimit për Sektorin e Kadastrit | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra e IT | Periudha e parë e vitit 2024 | / |
| | Shfrytëzimi joadekuat i pronës së paluajtshme komunale | | 6 | 7 | 42 | Menaxhimi i kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Planifikimi Urban dhe Rural | Mangësi në rregullativën e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban, rural, ndërtim dhe banim | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 5 | 9 | 45 | Hartimi dhe zhvillimi i rregullativës së brendshme duke përcaktuar kritere të qarta, të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural, dhe që parandalojnë veprimet subjektive | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Zbatim jo i plotë i planit rregullativ dhe planit urban që lidhen me fushën e planifikimit urban, rural banim dhe ndërtim. | | 5 | 7 | 45 | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban rural, ndërtim dhe banim. | Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Njësia e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Staf i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban, rural, banim dhe ndërtim | | 3 | 9 | 27 | Të sigurohet personel shtesë adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 | / |
| Ndërtimi, Banimi | Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 7 | 9 | 63 | Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje. | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyra e Inspektoriatit | Gjatë vitit 2024-2026 | / |
| | Mungesa e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve | | 3 | 10 | 30 | Të sigurohet personel shtesë adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoria për Inspekcion dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 2024 | / |
| | | | | | | | | | |
| | Mungesa e digjitalizimit për Lejet Ndërtimore | | 5 | 7 | 35 | Të sigurohet trajnimi i stafit për këtë fushë, pastaj IT fillon me procedurat e tjera | Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,, Zyra e IT | Gjatë vitit 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | digjitalizimit | | | |
| | Përditësimi dhe regjistrimi i familjeve që kërkojnë banim dhe ndihmë në banim në Data Bazën e Ministrisë, si dhe familjet në listë të pritjes, familjet përfituese. Mungesa e një listës ku regjistrohen familjet që kërkojnë banim | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshm e të komunës | 5 | 8 | 40 | Dy administratorë të banimit sipas Vendimit të KK nga Janari - Mars marrin për bazë, të gjitha kërkesat e adresuara sa i përket fushës së banimit dhe sipas lëndëve futen në sistem. | Drejtoria pë Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtori për Mirëqenie Sociale | TM4 – 2024, pastaj në vazhdimësi | / |
| Inspektimet | Planifikimi jo i duhur i inspektimeve | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshm | 5 | 6 | 30 | Plani vjetor i punës për Drejtorinë e Inspekcionit duhet të jetë i bazuar në metodëne bazuar në rrisk si dhe të përfshinë | Drejtoria e Inspekcionit, e Udhëheqësit Sektoreve, | Gjatë periudhës 2024-2026 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e të komunës | | | | informacione relevante | | | |
| | Kapaciteti i pamjaftueshëm profesional i inspektorëve | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës | 7 | 8 | 56 | Angazhimi në trajnime profesionale. | Drejtoria e Inspekcionit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | |
| | Stafi i pamjaftueshëm -numri i vogël i inspektorëve | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 7 | 42 | Rekrutimi i numrit të mjaftushëm dhe profesional i inspektorëve. | Drejtoria e Inspekcionit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Transparencë jo e plotë, për punën e njësisë së inspektimit | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës. | 6 | 7 | 42 | Të publikohet lista vjetore e bizneseve të cilat janë inspektuara dhe realizimin e planit në përqindje. | Drejtoria për Inspekcion dhe Zyra për Informim. | Gjatë vitit 2024 | |
| | Mbikqyrja inspektuese e pa mjaftueshme e operatorëve ekonomik. | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 7 | 42 | Planifikimi dhe fuqizimi i sistemit të mbikëqyrjes së operatorëve ekonomik. Zbatimi i masave dhe gjobat ndaj operatorëve të cilën veprojn pa regjistrim dhe licenca valide. | Drejtoria e Inspekcionit. | Gjate periudhës 2024-2026. | |
| Rekrutimi i Stafit dhe Mirëmbajtja në Arsimin Publik | Mungesa e harmonizimit të Ligjit për Zyrtarë Publik me rekrutimet nëpër Shkolla | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës | 3 | 6 | 18 | Harmonizimi i Ligjit për Zyrtar Publik dhe nxjerrja e akteve nënligjore për Zyrtar Publik | Niveli Qëndror | Periudha e parë e vitit 2024 | / |
| | Procedurat e tejzgjatura të rekrutimit | | 8 | 8 | 64 | Lehtësimi i masave të rekrutimit për mësimdhënës | Kryetari i Komunës, NJMBNJ Drejtora e Arsimit | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e Kuadrove në lëndët e | | 5 | 10 | 50 | Nxitja e nxënësve që të studiojnë lëndët: | Institucionet arsimore lokale, Mësimdhënësit | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkencave Natyrore dhe Matematikë | | | | | Shkencat Natyrore dhe Matematikë | | | |
| | Zvogëlimi i numrit të nxënësve që rezulton në shuarjen e normave të mësimdhënësve | | 9 | 10 | 90 | Vetëdijesimi i qytetarëve për të mos i lëshuar viset rurale. Përmirësimi i kushteve për mirëqenie sociale. Krijimi i prespektivës për të rinjë | Niveli Qëndror, Komuna | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mungesa e shërbimeve mbështetëse profesionale (Pedagog, Psikolog, Mësimdhënës Mbështetës dhe Asistent për Nxënësit me Nevoja të Veçanta) | | 5 | 7 | 35 | Shtimi i numrave dhe ndarja e buxhetit për personel shtesë për shërbime mbështetëse. | Niveli Qëndror, Komuna | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mungesa e Trajnimeve Adekuate | | 6 | 7 | 42 | Planifikimi i Trajnimeve Adekuate të Vazhdueshme | Drejtoria e Arsimit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rekrutimi, Ofrimi i Shërbimeve të Shëndetit Publik – | Mungesa e trajnimeve profesionale, sidomos për | | 6 | 8 | 48 | Planifikim dhe realizimi i trajnimeve profesionale si dhe nxitja e punëtorëve | Drejtoria për Shëndetësi, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ofrimi i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor | personelin shëndetësorë | | | | | për të marr pjesë në këto trajnime | | | |
| | Mungesa e stafit në Drejtorinë për Shëndetësi | | 4 | 6 | 24 | Rritja e buxhetit në kategorinë Paga dhe Mëditje, planifikimi i Personelit në planin e rekrutimit, sigurimi i hapësirave të punës (zyre) | Drejtoria për Shëndetësi, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| Implementim i i Projekteve dhe Politikave në Bujqësi | Mos Përcaktimi i kritereve te qarta dhe transparente ne ndarjen e subvencioneve | Ligjet, aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshm e të komunës | 3 | 6 | 18 | Të implementohet në tersi Rregullorja e brendëshme për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve Subvencione dhe të parandalohen vendimet që dëmtojnë integritetin e institucionit | Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e vetëdijes për rreziqet në sektorin e Bujqësisë | | 5 | 7 | 35 | Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve | Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve të | | 7 | 8 | 56 | Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe | Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | përdorimit të tokave bujqësore | | | | | përdorimit të tokës bujqesore | | dhe në vazhdimësi | |
| | Ndikimi nga jashtë dhe brenda komunës | | 4 | 6 | 24 | Komisionet e drejtorisë të jenë me kredibilitet dhe të pa anshëm | Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Tjetërsimi i tokës bujqësore | | 8 | 10 | 80 | Mungesa e Inspektorëve Komunal për kontrollimin dhe Mbrojtjen e tokave Bujqësore | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Drejtoria e Inspekcionit | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| Ofrimi i Shërbimeve të QPS – së | Monitorim i pamjaftueshëm i performancës së stafit | Ligjet, aktet nënligjore | 4 | 4 | 16 | Përdorimi i mjeteve për monitorimin e performancës. | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| (Qendra për Punë Sociale), dhe Zhvillimi i Politikave të Mirëqenies Sociale | Mungesa e stafit në kuadër të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale | në fuqi, dhe aktet e brendshm e të komunës | 8 | 6 | 48 | Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit për Plotësimin e Vendeve të Lira në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njërzore | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Mungesa e Transparencës në punën e zyrtarve | | 4 | 5 | 20 | Staf Profesional dhe jo Diskriminues | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Gjatë periudhës 2024-2026 | |
| | Qasje jo profesionale e stafit të komunës | | 5 | 6 | 30 | Shtimi i masave të kontrollit | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale, Njësia për | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | | |
| Ofrimi i Shërbimeve në Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve | Mungesa e stafit për realizimin dhe monitorimin e projekteve në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit rural | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshm e të Komunës | 6 | 9 | 54 | Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për rritje të numrit të zyrtarve në këtë Drejtori | Kryetari, Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, Zyra e Inspektoriatit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerzore | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Trajnimi i stafit në fushën e mjedisit | | 5 | 7 | 35 | Organizimi i trajnimeve nga fusha e Mjedisit | Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | Gjatë vitit 2024 | / |
| Ofrimi i Shërbimeve në Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve | Mungesa e mjeteve financiare për realizimin e Projekteve siq jane: Komposteret, Kontinjeret, Shportat rrugore etj. | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 5 | 8 | 40 | Planifikimi i buxhetit për realizimin e këtyre projekteve | Kryetari, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Numri i vogël i rojeve të pyllit, duke pamundësuar kontrollimin e tereneve pyjore. | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi | 8 | 9 | 72 | Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për Plotësimin e Vendeve të Lira në Sektorin e Pyjeve | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | TM4-2024 | / |
| | Mungesë e Infrastrukturës për kontrollimin e tereneve pyjore | | 7 | 9 | 63 | Krijimi i kushteve për Infrastrukturë për kontrollimin e tereneve pyjore, planifikimi i buxhetit | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Gjatë periudhës 2024-2026 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi i politikave dhe realizimi i projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Mosplanifikimi me kohë i projekteve dhe subvencioneve të OJQ-ve | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 4 | 5 | 20 | Të bëhet planifikimi vjetor rreth subvencionimit dhe monitorimit të OJQ-ve | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |
| | Mungesa e Drejtorëve në Institucione vartëse | | 8 | 9 | 72 | Rrekrutimi sa më i shpejtë i Drejtorëve për institucionet e të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport | Zyra e Kryetarit, NJMBNJ, DKRS | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |
| Zhvillimi i politikave dhe realizimi i projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Mosplotësimi i Vendeve të Punës | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 8 | 8 | 64 | Implementimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |
| | Mosrespektimi i Orarit të Punës | | 7 | 9 | 63 | Monitorimi i vijueshmërisë së punës nëpër institucione vartëse | Kryetari i Komunës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |
| | Mungesa e Trajnimeve Adekuate | | 6 | 7 | 42 | Planifikimi i Trajnimeve Adekuate të Vazhdueshme | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Strategjia për Kulturë dhe Rini | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi | 7 | 9 | 63 | Hartimi i Strategjisë për Kulturë dhe Rini | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Pjesa e parë e vitit 2024 | / |
| Realizimi i politikave në fushën e Sigurisë dhe Emërgjencave | Mungesa e organogramit adekuat | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 7 | 8 | 56 | Përgaditja e një Organogrami me përshkrimin e vendeve të punës për zyrtarët aktual dhe atyre që kemi mungesë | Drejtoria për Emergjenca dhe shërbime publike | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Mungesa e stafit në Drejtorinë për Siguri dhe Emergjenca si dhe në Njësinë për Zjarrfikës dhe Shpëtim | | 6 | 7 | 42 | Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për pranim të stafit profesional | Kryetari i Komunës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për shërbime publike dhe Emergjenca, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Mungesa e mos - miratimit të planeve dhe dokumenteve | | 3 | 4 | 12 | Mirtaimiin e planeve dhe dokumenteve emergjente për | Agjencioni për Menaxhimin e Emërgjencave, Komuna | Në Vazhdimësi | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | emergjente për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera përcjellëse të drejtorisë | | | | | fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera përcjellëse të drejtorisë | | | |
| | Mungesa e financave, Ndarje jo adekuate sipas planit buxhetor që bëhet nga Drejtoria Emergjenca dhe Shërbime publike paraqet pasoja negative për mos realizimin e intervenimeve emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore | | 9 | 9 | 81 | Ndarje adekuate sipas planit buxhetor për realizimin e intervenimeve emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore | Drejtoria për Emergjenca dhe shërbime publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa. | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Realizimi i politikave në fushën e Sigurisë dhe Emërgjencave | Mungesa e fondit emergjent. Mos ndarja e fondit emergjente për komunat për menaxhimin e fatkeqësive natyror, për mbështetje emergjente me material sipas dëmeve të bëra po paraqet pasoja jo të mira. | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 7 | 8 | 56 | Ndarja e një fondi emergjent për komunat për menaxhimin e fatkeqësive natyrore do të ishte lehtësim për kryerjen e punëve me efikasitet më të lartë | Niveli Qendror, | Në vazhdimësi | / |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e mos - definimit të kompetencave në mes Agjencionit për Menagjimin e Emërgjencave dhe Drejtorisë për Siguri dhe Emërgjenca në raport me Njësinë për | | 5 | 4 | 20 | Të bëhet definimi i kompetencave në mes Agjencionit për Menagjimin e Emërgjencave dhe Drejtorisë për Siguri dhe Emërgjenca në raport me Njësinë për Zjarrëfikje dhe Shpëtim | Qeveria, Agjencioni për Menaxhimin e Emërgjencave Komuna | Në vazhdimësi | / |
| | Zjarrëfikje dhe Shpëtim | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e trajnimeve të stafit, mos planifikim i trajnimeve dhe ngritjeve profesionale të stafit për menaxhimin e emergjencave është një pengesë e madhe në realizimin e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, dhe e njëjta paraqet pengesa në operativë | | 6 | 7 | 42 | Planifikimi i trajnimeve për stafin për menaxhimin e situatave emergjente | Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njërzore, Drejtoria për Siguri dhe Emërgjenca, Agjencioni për Menaxhimin e Emërgjencave Njësia për Zjarrëfikje dhe Shpëtim | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| Realizimi i politikave në fushën e Sigurisë dhe Emergjencave | Mungesa e posedimit të strehimoreve dhe mirëmbajta e tyre për strehim të popullatës së prekur nga | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshm | 7 | 7 | 49 | Planifikimi i dhe ndërtimi i strehimoreve do të ishte i domosdoshëm për kryerjen e punëve me efikasitet. | Komuna, Drejtoria për Siguri dhe Emërgjenca, Drejtoria për Mirëqenie Sociale | Në vazhdimësi | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në ekonomitë familjare | e të Komunës | | | | | | | |
| | Mungesa e makinerive dhe pajisjeve personale për zjarrëfikës | | 7 | 7 | 49 | Blerja e makinerive dhe pajisjeve personale për zjarrfikës po na paraqet probleme të mëdha në intervenim | Drejtoria Emergjenca dhe shërbime publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Prokurimit | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mos përcaktimi me kohë i Operatorit Ekonomik për menaxhimin e emergjencave të krijuara nga FNF po ndikon në mos kryerjen e punëve ashtu siç e kërkon faktori emergjent i cili paraqet pasoja dhe perceptim | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme të Komunës | 10 | 10 | 100 | Përzgjedhja me kohë e operatorit ekomomik | Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Prokurimit | Gjatë vitit 2024 | / |
| | negativ për komunën | | | | | | | | |
| Menaxhimi i Shërbimeve Publike | Mungesa e Stafit Profesional | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet | 5 | 8 | 40 | Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për rritjen e stafit | Zyra e Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria për emergjenca dhe Shërbime publike | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mos zhvillimi i procedurave të Prokurimit me kohë | e brendshm e të Komunës | 7 | 9 | 63 | Planifikimi me kohë i Prokurimit / Projekteve, inicimi me kohë i procedurave tenderuese | Zyra e Kryetarit, Zyra e Prokurimit, Drejtoria për emergjenca dhe Shërbime Publike | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| | Mungesa e Buxhetit | | 7 | 9 | 63 | Ndarja adekuate e buxhetit | Kryetari i Komunës, DBF | Gjatë periudhës 2024-2026 | / |
| Realizimi i Projekteve në fushën e Zhvillimit ekonomik dhe Turizmit | Mungesa e stafit për sektorin e Zhvillimit ekonomik dhe Turizmit | Ligjet, Aktet nënligjore në fuqi dhe Aktet e brendshme | 5 | 7 | 35 | Futja në planin e rekrutimit dhe parashikimeve buxhetore | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njërzore | Gjatë vitit 2024 | / |
| | Mungesa e Strategjisë për zhvillim ekonomik dhe Turizëm | e të Komunës | 3 | 7 | 21 | Parashikimi buxhetor për draftimin e strategjisë | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim ekonomik dhe Turizëm dhe Integrime Evropiane, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, | Gjatë vitit 2024 | / |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mungesa e kapaciteteve për vlerësimin e përputhjes se rregulloreve dhe dokumenteve komunale me legjislacionin evropian | | 10 | 7 | 70 | Ndryshimi i Legjislacionit Qendror dhe largimi i kësaj Kompetence e cila është problem të kryhet nga Niveli Lokal | Niveli Qëndror në bashkëpunim me Komunat | Në vazhdimësi | / |
| | Vonesat nga Niveli Qendror për leje dhe pëlqimin për realizimin e projekteve | | 9 | 10 | 90 | Përgatitja e parashikimeve buxhetore me kohë dhe aplikimi për leje dhe pëlqime me herët | Kryetari i Komunës, Drejtoria për, Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm dhe Integrime Evropiane | Gjatë kësaj periudhe 2024-2026 | / |
| | / | | / | | | | | | |

Për hartimin e Planit të Integritetit kontributin e tyre e kanë dhënë Zyrtarët e Komunës të emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01.Nr.104/02-31771/23, dt. 07.12.2023, të cilët në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës, Njësitë përgjegjëse, kanë hartuar Planin për Integritet.

Lista e përbërjes së Grupit Punues për Hartimin e Planit për Integritet:

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita/Njësia |
|---|---|---|
| | Grupi Punues | |
| 1 | Murat Burrniku | Koordinator /Kryesues, DAP |
| 2 | Festim Neziraj | Anëtar, Z.K |
| 3 | Mirlinda Dema | Anëtar, DAP |
| 4. | Muhamed Fera | Anëtar, DBF |
| 5. | Hasan Zharku | D.Arsimit |

Person përgjegjës për Mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit për Komunën e Kaçanikut është emëruar:

**z. Festim Neziraj - Zyrtar për burime njerzore.**